

## ÇKA ËSHTE RAPORTI KREDITOR ?

Raporti kreditor është një dokument i rëndësishëm i cili paraqet informacionin mbi kreditë tuaja. Ky informacion përdoret nga institucionet kredidhënëse në procesin e vlerësimit të aplikacionit tuaj për kredi.

## ÇFARË PËRMBAN RAPORTI KREDITOR ?

Raporti kreditor përmban në mënyrë të strukturuar të dhënat tuaja personale, të dhënat mbi kreditë tuaja si dhe të dhënat mbi kreditë e tjera ku ju jeni garantues ose jeni të lidhur në ndonjë rol tjetër.

Të dhënat do të paraqiten në raportin tuaj kreditor më së paku pesë vite prej momentit kur është bërë kthimi i plotë i saj.

## ÇFARË DUHET TË BËJ NËSE KAM VËREJTJE PËR PËRMBAJTJEN E RAPORTIT KREDITOR?

Për çdo të dhënë në raportin tuaj kreditor identifikohet edhe institucioni kredidhënës i cili e ka raportuar atë. Për çdo vërejtje që mund ta keni për të dhënat e përmbajtura në raport kreditor, ju mund ta kontaktoni institucionin përkatës kredidhënës.

*për më shumë....* [www.bqk-ks.org](http://www.bqk-ks.org)




Regjistri i Kredive të Kosovës (RKK) është një regjistër publik i cili menaxhohet nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës. RKK i shërben informimit kreditor të institucioneve kredidhënëse në Republikën e Kosovës.

RKK nuk e krijon informacionin kreditor por vetëm e mundëson mbledhjen dhe shpërndarjen e tij mes institucioneve kredidhënëse për qëllime të përmirësimit të cilësisë së kredive.

Raportimi i kredive të aprovuara dhe azhurnimi periodik i statusit të tyre nga të gjitha institucionet kredidhënëse është i obligueshëm.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës  
Adresa: Rr. Garibaldi nr.33  
10 000 Prishtinë, Kosovë  
Telefoni: 038 222 055 Ext 219  
[regjstriikrediteve@bqk-ks.org](mailto:regjstriikrediteve@bqk-ks.org)  
[www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org)



## RAPORTI KREDITOR PËRMES INTERNETIT

[www.raportikreditor.org](http://www.raportikreditor.org)



## PORTALI WWW.RAPORTIKREDITOR.ORG

Portali [www.raportikreditor.org](http://www.raportikreditor.org) është një web faqe interneti i cili përmban informata për raportin kreditor që mund t'i nevojiten një qytetari ose biznesi.

Ky portal u ofrohet qytetarëve dhe bizneseve të Kosovës nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, në mënyrë që të lehtësohet dhe thjeshtësohet qasja në raportin kreditor.

Këtë portal mund t'a vizitojë çdo qytetarë ose biznes që ka status kreditor, dhe dëshiron të ketë qasje në raportin e tij/saj kreditor. Regjistrimi dhe shërbimet që ofrohen përmes këtij portali janë falas.

### PROCESI I REGJISTRIMIT

1. REGJISTRIMI NË [WWW.RAPORTIKREDITOR.ORG](http://WWW.RAPORTIKREDITOR.ORG)
2. PLOTËSIMI I FORMULARIT DHE FOTOKOPJIMI I DOKUMENTIT IDENTIFIKUES.
3. FORMULARIN DHE KOPJEN E DOKUMENTIT IDENTIFIKUES E DORËZONI TEK REGJISTRIN I KREDIVE, PRANË BANKËS QENDRORE TË KOSOVËS.
4. REGJISTRIN I KREDIVE VERIFIKON TË DHËNAT DHE AKTIVIZON LLOGARINË E JUAJ ONLINE.
5. JU PRANONI EMAIL ME FJALËKALIMIN E JUAJ.
6. KYÇUNI DHE FILLONI PËRDORIMIN E SISTEMIT ONLINE TË RAPORTIT KREDITOR.

## SI FUNKSIONON REGJISTRIMI NË KËTË PORTAL?

Pasi të keni hapur këtë adresë:, [www.raportikreditor.org](http://www.raportikreditor.org) ju duhet të klikoni tek lidhja "Regjistrohu"

dhe pastaj do të hapet faqja e formës që ju duhet ta plotësoni me të dhënat tuaja personale (figura në vijim)

Pas plotësimit të fushave, ju do të pranoni një email i cili konfirmon regjistrimin tuaj në portalin e RKK-së. Në emailin konfirmues do të pranoni formularin me të dhënat tuaja të cilin duhet ta shtypni dhe t'ia bashkëngjitni këto dokumente:

**Për persona fizik:** Kopja e Pasaportës ose patentë shoferit ose letërnjoftimit (në të dy anët)

**Për persona juridik:** Kopja e regjistrimit të biznesit dhe dokumentit identifikues të pronarit.

Këto së bashku i dorëzoni tek Regjistri i Kredive, pranë Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës. Kjo nevojitet në mënyrë që llogaria të aktivizohet nga ana e punonjësve të Regjistrimit të Kredive. Pas verifikimit të dokumenteve të bashkëngjitura llogaria juaj do të aprovohet.

Kjo u mundëson juve qasje të drejtpërdrejtë në raportin tuaj kreditor i cili përmban të gjitha të dhënat e juaja kreditore për 5 vitet e fundit.

### PËRDORIMI

Kyçja në sistemin e regjistrimit të kredive bëhet duke e përdorur numrin e juaj personal si emër të përdoruesit (numri dhjetëshifror për dokument identifikues - për persona fizik, ose numri tetëshifror i regjistrimit të biznesit – për persona juridik) dhe si fjalëkalim shprehjen e cila ka ardhur në emailin e juaj të regjistruar.

Për arsye të sigurisë, rekomandohet që pas kyçjes të bëni ndryshimin e fjalëkalimit në mënyrë përkatëse.

Të jeni në dijeni se ju jeni plotësisht përgjegjës për qasjen në raportin e juaj kreditor, prandaj përdorni masat e sigurisë së informacionit për mbrojtjen e të dhënave të juaja të ndjeshme dhe konfidenciale.